



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1256 Prot.

Tiranë, më datë 11.08.2021

**VENDIM**  
**Nr. 525, datë 11.08.2021**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Urdhrit Nr. 223, datë 03.07.2020 “Për miratimin e rregullores për veprimtarinë e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale, Këshillit Teknik, Sekretarisë Teknike dhe Sportelit Unik të Saj”, pas shqyrtimit më parë të projektit në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 11.08.2021:

**VENDOSI:**

1. Shtyrjen e vendimmarrjes për projektin “Implementimi i Ndërhyrjeve për rritjen e Aksesit Cilësor në Kalanë e Beratit”, monument kulture i kategorisë së I-rë, me aplikues znj. Meleqe Spahiu, projektues restaurator z. Luçjano Bojaxhiu, zhvillues Bashkia Berat:
  - Të plotësohen detajet dhe specifikimet teknike në lidhje me mbështetjen e strukturës së rampës tek tabja, platformës së skenës në tokë, formati dhe përmbajtja e tabelave informative, fiksimi i korimanove;
  - Të specifikohet mënyra e aplikimit të vijëzimit me bojë i parkimeve;
  - Të sillet një variant tjetër i detajit teknik të vendosjes së platformës së rampës, duke evituar përdorimin e shtresave të betonit.
2. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
3. Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**  
**Elva MARGARITI**

**SEKRETAR**  
**Arta DOLLANI**